

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2016

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë¹)

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO njëmujore	R/REPO tremujore
7-Jan-16		2,810.00		
14-Jan-16		6,660.00		
21-Jan-16		18,312.00		
25-Jan-16			2,000.00	
28-Jan-16		11,070.00		
4-Feb-16		5,530.00		
11-Feb-16		5,980.00		
18-Feb-16		7,440.00		
24-Feb-16			1,400.00	
25-Feb-16		8,000.00		
3-Mar-16		6,400.00		
10-Mar-16		7,300.00		
17-Mar-16		8,480.00		
24-Mar-16		9,330.00		
31-Mar-16		8,540.00		
Burimi: Banka e Shqipërisë.				

1.1. Operacione të tregut të hapur

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2016, ndërhyrjet në tregun e parasë konsistojnë në operacionet e tregut të hapur për injektim të përkohshëm të likuiditetit, si dhe në transaksione shitblerjeje me të drejta të plota të bonove të thesarit në portofolin e Bankës së Shqipërisë me synim një rishpërndarje më të mirë të likuiditetit në sistemin bankar.

Sasia totale e likuiditetit të injektuar në sistemin bankar qe mesatarisht 10.2² miliardë lekë kundrejt 31.1 miliardë lekësh në tremujorin e mëparshëm. Nevoja për likuiditet ra ndjeshëm që në fillim të periudhës si rezultat i operacioneve të qeverisë për blerjen e

letrave me vlerë para maturimit dhe maturimit të letrave me vlerë të saj në fund të tremujorit të katërt të vitit 2015.

Me qëllim rishpërndarjen e likuiditetit, Banka e Shqipërisë ka kryer transaksione shitblerjeje me të drejta të plota me bankat e nivelit të dytë. Si rezultat i tepricës së likuiditetit në sistemin bankar, efekti neto i shitblerjeve të bonove të thesarit me të drejta të plota ishte ulja e portofolit të BSH-së me 2.15 miliardë lekë.

Në operacionet e tregut të hapur, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, për injektim të përkohshëm të likuiditetit në mesatarisht 7.5 miliardë lekë kundrejt 16 miliardë lekësh në tremujorin e mëparshëm. Si rezultat i rritjes së likuiditetit në sistemin bankar, u maturuan 4 injektimet njëmujore të muajit dhjetor si dhe injektimi 3-mujor i muajit tetor, ndërsa marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me maturim njëmujor u përdor vetëm në dy raste duke injektuar mesatarisht 2.6 mld lekë kundrejt 10.8 mld lekësh në tremujorin e katërt të vitit 2015. Nuk është përdorur në

¹ Shifrat janë në vlerë nominale.

² Shifrat janë me çmim blerjeje.

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të parë të vitit 2016


asnjë rast injektimi njëditor, ndërkohë që një tremujor më parë është përdorur në tre raste në ditën e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyrueshme dhe shuma mesatare qe 3.4 miliardë lekë.

1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Kredia njëditore është përdorur në 4 raste gjatë tremujorit të kaluar kundrejt 7 rasteve një tremujor më parë, por për mesatarisht 3.3 mld lekë kundrejt 2.9 mld lekësh në periudhën e mëparshme. Depozita njëditore, megjithëse me normë interesi 0.0% , në ndryshim nga tremujori i fundit i vitit 2015 kur nuk ishte përdorur në asnjë rast, u përdor në 21 raste.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblendhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për periudhën dhjetor 2009-mars 2016.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2009-2016 (me vlerë nominale)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN VALUTOR

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2016, Banka e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore.

Grafik 2: Ecuria e EUR/ALL dhe USD/ALL në tremujorin e parë të vitit 2016



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Në tremujorin e parë të vitit kanë vazhduar të lidhen marrëveshjet *swap* në valutë kundrejt atyre në lekë midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, sipas kërkesave të kësaj të fundit, që synojnë menaxhimin e likuiditetit të saj nëpërmjet investimit pranë BSH-së të tepricave në valutë. Shumat e investuara në marrëveshjet e pamaturuara *swap* në fund të tremujorit qenë 345 milionë euro dhe 50 milionë SDR kundrejt 330 milionë euro dhe 50 milionë SDR në fund të vitit 2015. Si rezultat i marrëveshjeve *swap* të lidhura në tremujorin e parë, blerjet e Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe qenë 41,541.00 milionë lekë dhe shitjet qenë 41,651.92 milionë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 40.00 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD dhe Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA).

Tabelë 2: Veprime valutore me institucione të tjera

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	41,541.00	41,651.92
TË TJERA (IDA, IBRD)	40.00	

Burimi: Banka e Shqipërisë.